



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1347/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhomat e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Procredit Bank Sh.A me seli në Prishtinë kundër debitorëve “Mbretëresha Gjeraldinë” NPT, me seli në Pejë, L.G. dhe D.G., që të dy nga Peja, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorve të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1512/22 të datës 31.07.2023, jashtë seancës me datë 02.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve “Mbretëresha Gjeraldinë” NPT, me seli në Pejë, L.G. dhe D.G., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1512/22 i datës 31.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1512/22 të datës 31.07.2023, e ka Refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorëve “Mbretëresha Gjeraldinë” NPT, me seli në Pejë, L.G. dhe D.G. që të dy nga Peja, të ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.380/21 të datës 16.06.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.

Kundër këtij aktvendimi debitorët përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën e debitorëve, të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës

– Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1512/22 të datës 31.07.2023 dhe të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorëve, ose lënda i kthehet në rivendosje gjykatë së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori me propozim që të refuzohet ankesa e debitorëve si e pa bazuar, të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1512/22 të datës 31.07.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Procredit Bank Sh.A, me seli në Prishtinë, me datë 14.06.2021, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorëve “Mbretëresha Gjeraldinë” NPT, me seli në Pejë, L.G. dhe D.G., që të dy nga Peja, në bazë të dokumentit të besueshëm – Kontratës Kornizë të Kredisë FW 89.645 të datës 16.12.2016, Kontratës së Kredisë për Biznes – normë fikse nr.30075883 të datës 20.12.2016, kontratës së Pengut nr.30075883, të datës 20.12.2016, i regjistruar me Konfirmimin e regjistrimit R-20161220-468, Kontratës së Hipotekës LRP – nr. rendor 8321/16 dhe LPR-nr.ref.2112/2016, e regjistruar me aktvendimin mbi regjistrimin e hipotekës me nr.prot.01-10/365 të datës 19.12.2016, të cilat marrëveshje paraqesin titull ekzekutiv në bazë të nenit 21. 22 të LPP-së, duke obliguar debitorët që të shlyejnë obligimet ndaj kreditorit në emër të kredisë nr.30075883 në shumë prej 35,291.86€.

Debitorët, kanë parashtruar prapësim ndaj urdhrit përbarimor P.nr.380/21 të datës 16.06.2021, në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, për shkak se dokumenti përbarimor nuk është Titull Ekzekutiv sipas nenit 22 të LPP-së, dokumenti përbarimor është i papërshtatshëm për përbarim, konform nenit 71 par.1 pika 1.1 të PLL-së dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozimin që të aprovohet prapësimi i

debitorëve, të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe të detyrohet kreditori që të bëjë pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorve, ka nxjerrë aktvendimin, KPPP.nr.1512/22 të datës 31.07.2023, me të cilin e ka Refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorëve “Mbretëresha Gjaraldinë” NPT, me seli në Pejë, L.G. dhe D.G. që të dy nga Peja, të ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.380/21 të datës 16.06.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjakë Radi..

Gjykata Komerciale- Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të dokumentacioneve në procedurën përmbarimore. Kjo gjykatë nuk ka gjetur asnjë provë materiale nga të cilat mund të vërtetohen pretendimet ankimore të debitorëve se në nenin 22 të kontratës për të vendosur për çfarëdo kontesti në mes të palëve, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë, për arsye se kontratat mbi bazën e të cilave është lëshuar urdhri përmbarimor paraqesin tituj ekzekutiv në bazë të nenit 21, 22 të LPP-së, konkretisht nenit 5 par.2 pika 1.7a të Ligjit nr.05/L-118 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën përmbarimore, në bazë të të cilave përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, të cilat dokumente përmbaruese përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP-së, për të qenë të përmbarueshëm.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatojë përbarimin. Dhomat e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar pretendimet ankimore por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta pasi që në këtë çështje juridike përbarimore, propozimi për përbarim është lejuar në bazë të akteve të lejuara përbarimore, që plotësojnë kushtet për përbarim dhe është i përshtatshëm për përbarim. Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II nr.1347/2023 me datë 02.07.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha